

POPULLI ËSHTË SHTYLLA



E DEMOKRACISË

ZEMRA E DEMOKRACISË

ANA (12), ELSA (12), VLERA (12), ARIS (12), LINDRIT (12), JON (12), ARBURON (12)



Përshëndetje të nderuar nxënës të të gjitha shkollave të Kosovës. Ne sot po mësojmë për demokracinë. Në këtë artikull mund të mësoni edhe ju për këtë temë

Sot kemi nderin të jemi pjesë e Punëtorisë së Demokracisë, e cila quhet “Demos-ti”. Këto Punëtori mund t’i gjeni edhe në adresën: www.demos-ti.org. Ne falenderojmë në emër të të gjithë klasës sonë organizatorët e projektit “Demos-ti”, të cilët po aftësojnë fëmijët për të ardhmen dhe për forcimin e demokra-



cisë. Këtu do të flasim për sistemin më të mirë të qeverisjes. Që nga kohët e lashta, kanë ekzistuar 3 lloje të qeverisjes. E para është autokracia. Në autokraci udhëheq vetëm një person, i/e cili/a quhej mbret/mbretëreshë. Pasi ai/ajo vdiste, fronin u trashëgohej pasardhësve të tyre. E dyta është oligarkia, në të cilën udhëheqin disa persona të caktuar, të cilët pushtetin e mbajnë vetëm për vete. E treta është demokracia, në të cilën udhëheq i gjithë populli. Ajo për herë të

parë është shfaqur në vitin 507 para erës sonë në Athinë. Aty është përdorur demokracia direkte. Pas saj u shfaq edhe demokracia përfaqësuese. Ju mund të pyesni, cilën formë të qeverisjes e përdor Republika e Kosovës? Pasi që ne jemi Republikë Demokratike, ne përdorim parimet e demokracisë përfaqësuese. Çfarë do të thotë kjo? Kjo do të thotë se ne dalim dhe votojmë nga moshë 18 vjeçare. Mirëpo, këtë të drejtë nuk e kishin të moshuarit, gratë, të varfërit dhe ata të cilët nuk kishin prejardhje nga Athina. Disa nga elementet e demokracisë janë: respekti, të drejtat e barabarta, barazia gjinore dhe gjithëpërfshirja. Këtë të fundit e duam më së shumti. Pikërisht për këtë arsye, ne si klasë kemi ndërmarrë iniciativë në bashkëpunim me të gjitha paralelet e klasës së VII-të të shkollës sonë. Ne jemi mbledhur dhe kemi përgatitur kartolina për fëmijët e prekur nga Sindromi Down. Kemi përgatitur pikërisht kartolina, sepse kemi dëgjuar që ata i pëlqejnë më së shumti ato. Ne me këtë përfundojmë këtë artikull, duke ju falenderuar për vëmendjen tuaj.



Gazetarët më të rinj të demokracisë

SË BASHKU AKTIV

AGIM (12), LENDI (12), NAZ (12), OLA (12), MYBERAE (12), FJOLLA (12), TUANA (12)



Të jesh qytetar aktiv nënkupton të jesh gjithmonë aty për të tjerët dhe për vendin tënd

Ne jemi nxënës të shkollës „Jeronim de Rada“ në Ferizaj nga klasa e VII-1. Fillimisht, kur erdhëm në “De-



Pena e diturisë. Diturinë mund ta fitojmë duke shfrytëzuar të drejtën e shkollimit

mos-ti,, na bën një pritje shumë të ngrohtë. Të gjitha edukatoret u prezantuan. Më pas filluam me një aktivitet ku u zbritëm shumë. U ndamë në grupe dhe secili grup kishte një edukatore. Edukatoret na treguan gjithçka rreth demokracisë. Më pas, gjithçka na u bë shumë e qartë. E kuputam pse ne kemi të drejta, pse kemi përgjegjësi, si ndikon demokracia në jetën tonë dhe si ndikojmë ne në demokraci.

Po fillojmë me të drejtat tona. Të gjithë ne qytetarët e

shteteve demokratike, kemi të drejta. Disa nga to janë: e drejta e shprehjes së lirë, e drejta e votës, e drejta e familjes, e drejta e shkollimit, etj. Mirëpo, ju lexues të kësaj gazete, mos harroni se me të drejta vijmë edhe përgjegjësitë. Prandaj, ne si qytetarë kemi përgjegjësi ndaj vendit tonë. Disa nga këto përgjegjësi janë: respektimi i ligjit, pagesa e taksave, mbrojtja e ambientit, ruajtja e pronave publike, etj.


Kjo që do të themi tani është shumë e rëndësishme, andaj kushtojini vemendje. Demokracia luan rol të madh në jetën tonë. Falë saj, jemi të barabartë dhe kemi të drejta. Por, edhe ne mund të luajmë rol të rëndësishëm në vendin tonë. Kur ndihmojmë vendin tonë, atëherë ne kemi ndihmuar në forcimin e demokracisë. E si mund ta bëjmë këtë? Ju tregojmë në pjesën e dytë të artikullit tonë.



Autorët e artikullit



Demokracinë e mbajmë në duar. E ndërtojmë dhe e ruajmë së bashku, si lulen më të bukur



E të votosh nuk do të thotë vetëm të përfundosh një përgjegjësi, por të bën të ndihesh pjesë e ndryshimit


Qytetarët e mirë dhe aktiv nuk mendojnë vetëm për vete. Ata janë të preokupuar dhe të brengosur me çfarë ndodh në komunitetin ku ata jetojnë.

Klasa jonë është treguar shumë aktive me një nga iniciativat që ajo ka marrë. Të gjithë së bashku, jemi mbledhur dhe kemi përgatitur ëmbëlsira. Më pas, ato ëmbëlsira i kemi shitur. Me të hollat e grumbulluara, ne ju kemi ofruar ndihmë fëmijëve të prekur nga Sin-

dromi Down. Kjo që kemi bërë ne quhet punë vullnetare. Përmes punës vullnetare, qytetarët mund të jenë aktiv në vendin e tyre. Përpos kësaj, ne mund të jemi aktiv edhe duke votuar, duke qenë pjesë e organizatave që mbrojnë të drejtat e njeriut dhe të fëmijëve, duke qenë pjesëmarrës në tubime publike, etj. E shihni pra, lexues të dashur, ne jemi ata që e bëjmë demokracinë me veprat tona.




Pastrimi i ambientit është njëra nga përgjegjësitë më të rëndësishme të qytetarëve të një vendi



Po ashtu, pjesëmarrja në zgjedhje cilësohet mjeti më i duhur për të marrë vendime në demokraci

LIGJET QË RREGULLOJNË JETËN TONË

OLTIONA (12), DIELL (12), ERËZA (12), BLEND (12), AGNESA (12), BUTRINT (11), ËMBLA (12)



Arsyen pse ne ndihemi krenarë me punën e Kuvendit, mund ta gjeni më poshtë


Gjëja më e rëndësishme për një individ është të jetë i shëndetshëm. Për të qenë i shëndetshëm duhet të kemi kujdes në mënyrën se si ushqehemi, se si vishehemi, etj. Një problem tjetër, i cili mund të ndikojë negativisht në shëndetin tonë është edhe ambienti i ndotur, si në hapësirë të hapur, ashtu edhe në vendet e mbyllura. Fatmirësisht, në Kosovë funksionon ligji, i cili ndalon rreptësisht pirjen e duhanit në vendet e mbyllura, gjë që është një ligj mëse i nevojshëm. Në të kundërtën, në një ambient ku pihet duhani, ne vetëm sa do të sëmureshim. Për këtë e shumë ligje të tjera, të cilat na e mbrojnë shëndetin dhe na e rregullojnë jetën tonë, kujdeset Kuvendi.

Kuvendi është institucion shumë i rëndësishëm, ku punojnë deputetët. Deputetët janë përfaqësuesit tanë, sepse ne jemi ata të cilët i zgjedhim me anë të vo-

tave. Gjithsej janë 120 deputetë, ku 20 prej tyre janë pjesëtarë të 7 komuniteteve jo shumicë: komuniteti romë, ashkali, serb, egjiptian, boshnjak, goran, si dhe komuniteti turk.

Përveç ligjeve që dalin nga ky institucion, brenda tij kryhen edhe detyra të tjera, siç janë: përfaqësimi i popullit, kontrollimi i punës së Qeverisë, zgjedhja e Kryetarit të Kuvendit, zgjedhja e Presidentit, zgjedhja e Avokatit të Popullit, etj.

Sot kuptuam diçka shumë të rëndësishme. Ajo është lidhshmëria e Kuvendit të Kosovës me jetët tona. Çdo gjë që diskutohet aty, ka për qëllim përmirësimin e gjendjes së qytetarëve të Kosovës. Kjo na lumturon neve pa masë, sepse tani e dijmë ku të mbështetemi. Jo më kot Kuvendi quhet „Shtëpia e Popullit“, pasi që realisht, të gjitha preokupimet që ata i kanë për shtetin e Kosovës, janë të ngjashme me ato që i kanë edhe prindërit tanë.




Ligjet bëhen për të mirën tonë, andaj duhet t'i respektojmë



Jemi krenarë me rolin e sotëm si gazetarë

LIRIA PËR TË ZGJEDHUR DHE PËR T'U ZGJEDHUR

VLERA (11), FLANDRA (12), LINDON (12), FLANDRA (12), ERIND (12), ERIN (12), VLOBES (12)



Brenda çdo shoqërie ekzistojnë opinione, nevoja dhe pikëpamje të ndryshme për problemet e përditshme. Gjithashtu, ekzistojnë mënyra të ndryshme se si qytetarët organizohen. Për këtë ekzistojnë partitë politike, që të ndihmojnë qytetarët dhe të çojnë vendin përpara

Ju të dashur lexues, sot në artikullin tonë do të merrni shumë informata për zgjedhjet dhe rëndësinë e tyre. Po ashtu, do të informoheni për partitë politike. Do të kuptoni çka janë ato, cili është qëllimi i tyre dhe pse qytetarët iu bashkohen atyre. Le të fillojmë së pari me atë që është më e rëndësishmja, zgjedhjet. Zgjedhjet janë elementi bazë i një shteti demokratik, sepse përmes tyre qytetarët e jetësojnë një të drejtë, e cila ka peshë shumë të madhe. Qytetarët dalin në zgjedhje për të votuar kandidatët që ata dëshirojnë dhe mendojnë se do t'i plotësojnë nevojat dhe kërkesat e tyre. Në Kosovë kemi dy lloje zgjedhjesh: zgjedhjet lokale dhe zgjedhjet qendrore. Në zgjedhjet lokale, qytetarët votojnë për kandidatët për kryetarë komune dhe për asamblenë komunale. Këta kandidatë mund të jenë të pavarur, por shumica prej tyre iu përkasin partive të ndryshme politike. Për partitë dhe rolin e tyre do të informoheni më shumë në artikullin tjetër. Ndërsa, në zgjedhjet qendrore, po ashtu, qytetarët janë ata të cilët votojnë. Por, në këto zgjedhje ata votojnë për deputetët, të cilët kanë rol shumë të rëndësishëm në jetën e tyre. Ne të gjithë e dijmë se çdo shoqëri ka nevoja dhe kërkesa. Ato mund të ndryshojnë shumë nga njëra-tjetra, por duhet dëgjuar nga dikush. Kur edukatorja përmendi deputetët, ajo na pyeti nëse dikush nga ne do të bëhet deputet në të ardhmen. Ishte Erini, ai i cili tha: “Po, unë, do të punoj shumë

në këtë aspekt, sepse vendi im ka nevojë për njerëz punëtorë.. Ai shtoi: “Unë jam qytetar ideal për këtë, sepse edhe si fëmijë që jam, i dëgjoj hallet dhe bren-gat e shokëve dhe shoqeve të mia. E jo vetëm të tyre, por edhe të familjarëve të mi. Për çdo gjë, mundohem gjithmonë të gjej një zgjidhje..” Përpos kësaj, ai tha, “Unë edhe si nxënës mundohem çdo herë ta realizoj atë që premtoj..” Një ndër premtimet që ai ia kishte bërë klasës ishte që nëse nxënësit do të mbanin qetësi në një orë të caktuar, ai do t'i zvogëlonte dënimet për mos respektimin e disa rregullave nga ana e nxënësve. Kur Erini përfundoi së foluri, shoqja Vlera ia ktheu: “Erin, ti me të vërtetë e meriton të jesh përfaqësues i popullit, sepse ti e përfaqëson klasën tonë në mënyrën më të mirë të mundshme..”




E tashmja dhe e ardhmja e vendit janë qytetarët aktiv

Në artikullin paraprak keni mësuar më shumë për zgjedhjet. Thënë më mirë, keni marrë më shumë informata rreth asaj teme. Ndërsa, në këtë artikull, unë Flandra dhe Erindi do t'iu tregojmë më shumë rreth partive politike. Do t'iu flasim se pse ekzistojnë ato dhe si na ndihmojnë neve qytetarëve që të kemi një jetë më të mirë.


Partitë politike janë bashkim i disa qytetarëve, të cilët kanë ide dhe mendime afërsisht të njëjta. Ata kanë për qëllim të realizojnë pikëpamjet e tyre politike. Këtë e bëjnë me ardhjen e tyre në pushtet. Por, përse duhet të bashkohen njerëzit në grupe për t'i realizuar pikëpamjet e tyre? Kjo sepse në një vend ku numri i banorëve është shumë i madh, mundësia për të bërë ndryshime si një individ është shumë më e vogël sesa kur funksionon si grup. Për këtë, qytetarët formojnë dhe bashkohen me ato parti që mendojnë se i kanë idetë e njëjta. Partitë politike janë të hapura për të gjithë qytetarët, ato formohen nga qytetarët dhe punojnë për të mirën e tyre.



Të gjithë qytetarët mbi moshën 18 vjeçare e gëzojnë të drejtën për të marrë pjesë në procesin zgjedhor. Me anë të votës, ata zgjedhin partitë të ndryshme për të udhëhequr vendin



Kosova është vend shumë partiak, sepse në garë për pushtet nuk e kemi vetëm një parti, por i kemi disa parti. Qytetarët janë të lirë t'iu dëgjojnë planprogramet e tyre dhe të kandidatëve gjatë fushatës zgjedhore dhe në fund. Në ditën e zgjedhjeve ata votojnë për atë parti dhe ata kandidatë që më së shumti iu përshtaten kërkesave të tyre. Mundësia për të zgjedhur më të mirën është shumë e madhe, sepse në Kosovë ka spektër të gjerë politik



Objektivi kryesor i partive politike është që të kenë pas vetes sa më shumë qytetarë e që të punojnë dhe t'iu përfaqësojnë në mënyrën më të mirë të mundshme. Partia e parë shqiptare është themeluar nga Fan Noli në vitin 1920



IMPRESUM



Ky publikim është produkt i punës së pjesëmarrësve të projektit „Demos-ti“ i cili realizohet nga



REPUBLIKA E KOSOVËS / KUVENDI
REPUBLIKA KOSOVA / SKUPŠTINA
REPUBLIC OF KOSOVO / ASSEMBLY

i implementuar nga



Projekti është mundësuar dhe përkrahur nga



ERSTE Stiftung

Redaktohet nga
Kuvendi i Kosovës

Qëllimi i publikimit
Edukimi qytetar nëpërmes metodave edukative joformale

shtypur nga
TOKA

Na kontaktoni për të marrë pjesë: Pjesëmarrësit:
Tel: +381 38 704 560 SHFMU „Jeronim de Rada“
E-mail: info@demos-ti.org Klasa: VII-1
Website: www.demos-ti.org Vendi: Ferizaj